



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ / ____ /2018

V E N D I M

Nr. 60, Datë 07 / 03 / 2018

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr. 124, datë 21.09.2017, të bërë nga L.Z, kundër shkollës 9-vjeçare “9 Tetori” dhe Zyrës Arsimore Sarandë në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “etnisë”¹.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues deklaroi se: “Me Vendimin Nr. 1182/1 prot, datë 01.09.2016 është emëruar si mësuese e lëndës Matematikë-Fizikë në shkollën 9-vjeçare “Adem Sheme” Sarandë, por ngarkesa mësimore është plotësuar me 8 orë mësimore në shkollën “9 Tetori”. Me shkresën datë 11.04.2017, L.Z i është drejtuar ZA Sarandë dhe drejtorit të shkollës “9 Tetori” që të iniciohej procedura për emërimin e saj në vend të mësueses H.S e cila mbushte moshën për pension pleqërie. Në Shkurt 2017, drejtoresha e shkollës “9 Tetori” L.M i shkurton ngarkesën mësimore nga 8 orë në 6 orë dhe sistemon një mësuese tjetër, G.B. Në datë 07.09.2017, drejtori shkollës i ka deklaruar se nuk ka vend në shkollën “9 Tetori”, ndërkohë që ka sistemuar me kohë të plotë mësuesen G.B. Me këtë mënyrë drejtoresha e shkollës e ka privuar nga vendi i punës duke favorizuar mësues të tjerë, në shkelje të ligjit duke mos shpallur vendin vakant dhe as sistemimin për mësuesit që kërkojnë lëvizje paralele”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit.

¹ Referuar Kartës së Identitetit të Republikës së Greqisë AN 076679 datë 13.03.2017 të L.Z.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi për shkak të etnisë është një nga shkaqet për të cilin ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje dhe bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10221/2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Bazuar në nenin 33/4 të ligjit Nr. 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ankesa e paraqitur nga subjekti ankues, L.Z², është e vlefshme nga pikëpamja formale pasi nuk ekziston asnjë nga rastet përjashtuese të parashikuara në këtë nen, që do ta bënte këtë ankesë të papranueshme. Si pasojë ankesa iu nënshtrua shqyrtimit të plotë.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 962, datë 05.10.2017 është bërë njoftimi dhe i është kërkuar informacion subjektit, Shkollës “9 Tetori” dhe Zyrës Arsimore Sarandë, në lidhje me ankesën për pretendimin për diskriminim të paraqitur nga L.Z.

Me shkresën nr. 790/1, datë 12.10.2017 të dërguar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Zyra Arsimore Sarandë, në mes të tjerash ka informuar se: “Në shtator 2017, drejtorja e shkollës “9 Tetori” ka konkluduar që, meqënëse nuk ka patur mësues për lëndën e

² Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi me Vendimin nr.60, datë 07.04.2016 është shprehur për pretendimet e anksës nr.105, datë 11.12.2015 të L.Z.

informatikës, ka shpërndarë 16 orët e kësaj lënde tek mësuesit e profilit të përafërt me të, që është matematikë-fizikë, pra nuk është shpallur si vend i lirë për lëndën e matematikës. Mësuesja G.B, e caktuar me emërim të përkohshëm (kontratë 1-vjeçare në periudhë prove) plotësonte ngarkesën në dy shkolla: “Shefqet Sulejmani” Gjashtë dhe “9 Tetori” Sarandë dhe ky emërim është bërë duke ndjekur renditjen sipas portalit “Mësues për Shqipërinë” në të cilën G.B është renditur në vendin e dytë ndërsa L.Z në vendin e pestë. Në vitin shkollor 2017-2018 mësuesja L.Z ka 15 orë në shkollën “Adem Sheme” ku ka emërimin dhe 6 orë mësimore plotësuese në shkollën “9 Tetori””.

Me shkresën nr. 360, datë 12.10.2017 të dërguar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Drejtoria e shkollës “9 Tetori” Sarandë, në mes të tjerash ka informuar se: “L.Z, në shkollën “9 Tetori” për vitin shkollor 2016-2017, ka plotësuar ngarkesën mësimore javore nga shkolla “Adem Sheme” pasi në atë shkollë ka emërimin. Mësueses G.B i është dhënë ngarkesa mësimore, pasi me shkresën nr.81/1, datë 02.02.2017, shkollës “9 Tetori” i është drejtuar “Njoftim për vendimin e Komisionit të Vlerësimit për lëvizjet paralele, emërimin të përkohshëm e sistemim të ish-drejtuesve” në të cilën ishte vendosur se mësuesja G.B, kandidatë nga portali kalon në pozicionin e mësueses së lëndës matematikë-fizikë. Në zbatim të vendimit të komisionit është lidhur kontrata e punës për 1 vit me ngarkesë 14 orë në shkollën “9 Tetori” plus 6 orë në shkollën “Shefqet Sulejmani”, kontratë e cila është në fuqi. Me daljen e një mësueseje në pension, G.B u kompletua me ngarkesën mësimore brenda institucionit dhe si pasojë nuk ka vend pune vakant. Mësuesja L.Z për periudhën e pretenduar nuk ka qenë apo është punonjëse në juridiksionin e shkollës “9 Tetori” dhe si e tillë shkolla “9 Tetori” nuk mund të bëjë sistemimin e L.Z apo ta ketë diskriminuar. Kërkesa për emërim e cituar nga L.Z nuk i bëhet drejtuesit të institucionit arsimor por i drejtohet institucionit të njësisë arsimore vendore pranë ZA dhe shqyrtimi i tyre kryhet nga Komisioni i Vlerësimit dhe vendimi i përcillet institucionit arsimor për veprim. Rasti i L.Z, duke mos qenë kompetencë e shkollës “9 Tetori” nuk ka vend për diskriminim për shkak të etnisë”.

III. Në përfundim të procedurave të shqyrtimit të ankesës dhe bazuar në dokumentacionin e administruar, Komisioneri vëren se:

Ankuesja L.Z, me shkresën nr.1182/1, datë 01.09.2016 “Vendim për emërim punonjësi mësimor” të drejtorit të shkollës “Adem Sheme” Sarandë, mbështetur në vendimin e Komisionit të Vlerësimit të ZA Sarandë, është emëruar si mësuese e lëndës matematikë-fizikë në shkollën “Adem Sheme”.

Me shkresën “Kërkesë” datë 11.04.2017, drejtuar ZA Sarandë dhe Drejtorit të Shkollës “9 Tetori” Sarandë, L.Z ka kërkuar lëvizje paralele drejt shkollës “9 Tetori” në vendin e punës që do krijohet me mbushjen e moshës për pension të një mësueseje të shkollës “9 Tetori”.

Komisioni vlerësues për lëvizje paralele, emërim të përkohshëm e sistemim të ish-drejtuesve me shkresën nr.81/1, datë 02.02.2017, ka njoftuar drejtorinë e shkollës “9 Tetori” si më poshtë: 1. G.B, kandidatë nga portali, kalon në pozicionin e mësueses së matematikës dhe fizikës, vend

vakant në shkollën “9 Tetori”. 2. Përsa më sipër, kryeni procedurat për emërim të përkohshëm, me kontratë 1-vjeçare.

Drejtoria e shkollës “9 Tetori” me shkresën nr. 136/1, datë 02.02.2017 “Kontratë Individuale Pune me kohë të caktuar” (1 vit kalendarik) ka lidhur kontratë pune me mësuesen G.B për lëndën matematikë-fizikë për ngarkesën mësimore 14 orë në shkollën “9 Tetori” dhe 6 orë mësimore në shkollën “Shefqet Sulejmani”.

Nga verifikimi i kryer në listën e renditjes sipas portalit “Mësues për Shqipërinë” për vitin 2015-2016 të vënë në dispozicion nga ZA Sarandë, rezultoi se: në renditjen e konkuresve për lëndën matematikë, G.B me barkod testi 15T03750 është e renditur e treta me shumën totale prej 54.20 pikë³ (pikë totale 12.20 plus pikët e portalit 42), ndërsa L.Z me barkod testi 15T03755 është e renditur e pesta me shumën totale 53.70 pikë (pikë totale 7.70 plus pikët e portalit 46).

Në Kreun 4/2 të Udhëzimit nr. 38, datë 06.10.2015 “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar” përcaktohet se: *“Kandidati me numrin më të madh të pikëve ftohet nga komisioni dhe zgjedh një nga vendet e lira të punës (me ngarkesë të plotë apo të pjesshme, të përkohshme apo të përhershme), sipas preferencës së tij, në prani të drejtorëve të institucioneve arsimore ku janë vendet e lira të punës”*, ndërsa në pikën 4 të këtij kreu, përcaktohet se: *“Kandidati emërohet nga drejtori i institucionit arsimor me kontratë individuale pune me afat një vit kalendarik”*.

Referuar legjislacionit të sipërcituar dhe procedurave të kërkuara arrihet në përfundimin se lidhja e kontratës një vjeçare mes shkollës “9 Tetori” dhe G.B për pozicionin e mësueses së lëndës matematikë-fizikë në datë 02.02.2017, është kryer sipas procedurave të kërkuara nga legjislacioni në fuqi, pasi mësuesja G.B është e renditur me numër më të madh të pikëve në portalin “Mësues për Shqipërinë” si dhe është rekomanduar sipas procedurës nga Komisioni i Vlerësimit i ZA Sarandë.

Gjithashtu, referuar Kreut 7 të Udhëzimit nr. 38, datë 06.10.2015 “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar” vlerësohet se të njëjtat kritere përdoren nga Komisioni i Vlerësimit dhe për lëvizjen paralele të mësuesve, në të cilën kriteri kryesor është renditja e kandidatëve sipas portalit “Mësues për Shqipërinë”.

Po ashtu, referuar nenit 55/3/b të Urdhrit nr. 343, datë 19.08.2013 “Për miratimin e Dispozitive Normative për sistemin arsimor parauniversitar”, përcaktohet se: “Drejtori, pas këshillimit me këshillin e mësuesve: b) cakton ngarkesën mësimore të mësuesve”, referuar kësaj pike vlerësohet se është në tagrin e drejtuesit të institucionit arsimor shpërndarja dhe rregullimi i ngarkesës mësimore për mësuesit që ka në juridiksion, gjithmonë duke respektuar legjislacionin mbi normat e punës mësimore-edukative dhe profilin e kualifikimit të mësuesit.

³ Në Kreun 4 pika 4 të Udhëzimit nr.38, datë 06.10.2015 përcaktohet se: Komisioni, pas përfundimit të afateve të ankimit bën renditjen e kandidatëve sipas pikëve totale që nxirren nga shuma e pikëve të marra në vlerësimin e dosjes së aplikimit dhe pikëve të marra në testimin “Mësues për Shqipërinë”.

Për sa më lart dhe referuar Udhëzimit nr. 38, datë 06.10.2015 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar”, vlerësohet se procedurat e emërimit dhe lëvizjes paralele të punonjësve mësimore kryhen nga drejtuesi i institucionit mësimor pas shqyrtimit të dosjeve dhe renditjes së kandidatëve nga Komisioni i Vlerësimit i njësisë arsimore dhe nuk është në tagrin e drejtuesit të institucionit arsimor që të kryejë lëvizjen paralele të mësuesve dhe si rrjedhim nuk mund të ketë veprime direkte të trajtimit të pabarabartë të subjektit ankues.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Në nenin 12/1/b) të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet se: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve”.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Për të vërtetuar se ndaj ankuses ka një sjellje diskriminuese nga ana e ZA Sarandë, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”⁴ dhe trajtimit të pafavorshëm të ankuses.

Nga dokumentet e administruara gjatë trajtimit të ankesës, dhe shpjegimet e dhëna nga ZA Sarandë, lidhur me marrëdhëniet e punësimit mes subjektit ankues dhe ZA Sarandë, vlerësohet se L.Z ka patur marrëdhënie punësimi me kontrata të përkohshme me ZA Sarandë që prej vitit 2012 dhe në vitin 2015 ka marrë emërimin si mësuese definitive në shkollën “Shefqet Sulejmani”

⁴ Në interpretim të nenin 1, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, “...ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Gjashtë dhe një vit më vonë është emëruar si mësuese definitive në shkollën “Adem Sheme” Sarandë. Pra vlerësohet se nuk ka patur veprime, paragjykime apo trajtim të pabarabartë për shkak të etnisë së L.Z, aq më tepër që në ankesën nr.105, datë 11.12.2015 të depozituar pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, L.Z ka pretenduar sjellje diskriminuese për shkak të gjendjes ekonomike.

Për sa më lart, Komisioneri vlerëson se nuk konstatohet trajtim i pabarabartë i ankueses në raport me mësuesen G.B, pasi veprimet e Zyrës Arsimore Sarandë dhe shkollës “9 Tetori” nuk kanë qenë diskriminuese në drejtim të trajtimit të kërkesës së L.Z.

Ndërsa sa i takon pretendimit të ankueses mbi vërtetësinë apo manipulimn e shkresës nr. 81/1, datë 02.02.2017 të lëshuar nga Komisioni i Vlerësimit, Komisioneri vlerëson se, pretendimi për falsifikim apo manipulim të dokumentacionit zyrtar duhet ndjekur gjyqësisht, përmes kallëzimit penal, sepse është jashtë kompetencave të parashikuara në ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, neni 12/1/a), b), nenin 32, pika 1/a), c), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të shtetas L.Z, për shkak të etnisë, nga ana e Zyrës Arsimore Sarandë dhe drejtores së shkollës “9 Tetori” Sarandë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afateve ligjore.

Irma BARAKU

KOMISIONERI

(shkaku: etnia)
(fusha: punesim)